



Viti i VII-të i Botimit, Nr.1,
Qershorë 2016

PROBLEMET JURIDIKO-NDËRKOMBËTARE NË NJOHJEN E KOSOVËS

Kersi Kurti

Universiteti i Tiranës “Instituti i Studimeve Europiane”

Adresë kontakti: kersikurti@gmail.com

Përmbledhje

Kosova, emër ky shumë i dëgjuar në mbarë botën. Por ç’është Kosova, ç’kërkon ajo, nga e ka prejardhjen dhe a e ka të drejtën ajo në kërkesën e saj për pavarësi? Për të arritur në këtë përfundim, jemi njohur me shumë opsione të cilat paraqiten për zgjidhje shkallë-shkallë deri në shprehjen e vullnetit të lirë të popullit shqiptar të Kosovës për të vendosur fatin e tij. Metodologjia që është përdorur gjatë hartimit të kësaj teme është mbështetur në pikëpamjet doktrinale që ekzistojnë në fushën e të drejtës ndërkombëtare për çështjen e Kosovës, në legjislacionet e Kosovës, të vendeve të rajonit dhe më gjerë në arenën ndërkombëtare, janë shfrytëzuar informacionet dhe literatura shkencore nga botimet në revista dhe konferenca shkencore që kanë trajtuar po këtë problematikë. Në këtë artikull trajtohet evolucioni themelor i procesit të njohjes ndërkombëtare të Kosovës si shtet i pavarur, përgjatë dekadave të fundit. Nën administrimin ndërkombëtar, pavarësisht vonësive të dukshme e devijimeve të shumta me natyrë subjektive dhe objektive, të brendshme dhe të jashtme, procesi demokratik në Kosovë ka pasur përgjithësisht një spirale ngritëse drejt konsolidimit politik, demokratik e institucional dhe statusit përfundimtar të vendit. Përfundimisht, u arrit që sipas deklaratës kushtetuese, Kosova të shpallet shtet i pavarur më 17 Shkurt 2008. Tashmë Republika e Kosovës është zyrtarisht një shtet i pavarur, neutral me një autonomi të gjerë duke pasur të gjitha të drejtat e një shteti.

Fjalë çelës: pavarësi, njohje, rezolutë, UÇK, NATO, OKB, UNMIK.

INTERNATIONAL AND LEGAL PROBLEMS IN THE RECOGNITION OF KOSOVA

ABSTRACT

Kosovo, I strongly believe that this name is known all over the world. But what is Kosovo and what does it want? Does it have the right to demand and enjoy its independence? To reach this conclusion we are aware of too many options that call for understanding and

gradual solutions of expressing free will of Albanian people of Kosovo. The methodology used during the development of this topic it is based on doctrinal views that exist in the field of international laws on the Kosovo issue. Kosovo legislations, the countries of the region and the wider international arena, in resolutions designed to achieve final status of Kosovo. Also, there are used information from the scientific literature and publications in journals and scientific conferences that addressed the same issue. In this article it is treated the great evolution of the process of international recognition of Kosovo as an independent country. In spite of apparent deviation and delays of subjective and objective nature, the process of recognition of Kosovo has had a lifting spiral towards political consolidation as well as the final status of the country. Finally, according to constitutional declaration Kosovo was declared independent on 17-th February 2008. Now officially the Republic of Kosovo is an independent state, neutral with a wide autonomy having all the rights of a state.

Key words: independence, recognition, resolution, UÇK, NATO, OKB (UNO), UNMIK.

Kosova dhe historia e saj

Zyrtarisht Kosova që prej 2 Shkurtit 2008, njihet si Republika e Kosovës. Ajo është një shtet i pavarur në Evropën Juglindore. Kosova ka një histori të dhimbshme në shekullin e kaluar, ashtu si gjithë territoret etnike shqiptare, njësoj si edhe e gjithë historia e kombit tonë. Ka një “alfabet” historik, politik dhe juridik që është përshkruar aq dendur me logjikën teorike dhe praktike të “alfabetit” të krimit, deri në tragjedi. Nga viti 1912 dhe deri tek pushtimi i hapur i Kosovës nga serbët, si dhe të territoreve të tjera etnike nga ish-mbretëria jugosllave, historia e Kosovës ndërthuret ashpërsisht: në Londër 1913/1915, në Versajë 1919 etj.

Disa nga datat më të rëndësishme për Kosovën në shek XX dhe fillim shekullin XXI dhe rrjedha e këtyre ngjarjeve:

1945: Përfundon Lufta e Parë Botërore. Shqipëria komuniste nuk ka asnjë pretendim territorial ndaj Kosovës.

31 Janar 1946: Lind Republika Popullore Federative Jugosllave. Kosova shpallet provincë autonome, por krejt e varur nga Beogradi.

1974: Kushtetuta e re e Jugosllavisë përforcon autonominë e Kosovës, duke krijuar institucione politike të mëvetësishme, por si rrodhën këto ngjarje? Dhunimi i pozitës kushtetuese të Kosovës, të kushtetutës së 1974, është bërë me një sërë veprimesh dhe aktesh antikushtetuese nga pala serbe, duke filluar që nga viti 1981. Që nga viti 1981, e sidomos pas debateve kushtetuese të vitit 1988-1989, në opinionin serb dhe jugosllav u trajtua e ashtuquajtura “padrejtësi” që i ishte bërë Serbisë në raport me njësitë e tjera federale të Jugosllavisë. Serbia e rrënoi ushtarakisht subjektivitetin politik të Kosovës nëpërmjet disa akteve antikushtetuese, ku ndër më të rëndësishmet përmenden:

- Amendamentet 4-49, të kushtetutës së Serbisë, 28 Mars 1989;
- Ligji mbi veprimin e organeve Republikane në rrethana të veçanta, 26 Qershor 1990;
- Kushtetuta e Republikës së Serbisë, 28 Qershor 1990;
- Ligji mbi ndalimin e punës së Kuvendit të Kosovës dhe të Këshillit Ekzekutiv të Kuvendit të Kosovës, 5 Korrik 1990;
- Ligji mbi pezullimin e punës së kryesisë së KSA të Kosovës, 18 Mars 1991 ⁽¹⁾.

Lufta për UÇK dhe ndërhyrja e NATO-s

Gjatë viteve '90, shoqëritë shqiptare në mërgim u angazhuan për ngritjen e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, pjesëtarët e së cilës u trajnuan në Shqipëri dhe u hodhën më pas në territorin kosovar. Dëshmorët e parë të Luftës Çlirimtare, Zahir Pajaziti, Hakif Zejnullahu dhe Edmond Hoxha, ishin ndër drejtuesit e sulmeve të para guerile, pas së cilave UÇK-ja u shfaq botërisht më 28 Nëntor 1997. Trazirat e vitit 1997 në Shqipëri dhanë mundësi që arsenalin luftarak i depove të ushtrisë shqiptare t'i shkonte UÇK-së. Duke përdorur si pretekst ndjekjen e UÇK-së, Serbia intensifikoi terrorin e vet mbi popullsinë shqiptare dhe kreu një numër të madh masakrash mbi civilët në Drenicë më 28 Shkurt 1998.

Luftimet u ashpërsuan gjatë pranverës së vitit 1998, me mësymjen e Dukagjinit dhe gjatë verës me ofensivën serbe dhe masakrat në Rahovec. Më 15 Janar 1999, masakra e Reçakut, e dëshmuar nga misioni vëzhgues i OSBE-së nën udhëheqjen e ambasadorit William Walker, fitoi simpatinë ndërkombëtare për popullin e Kosovës. Në shkurt 1999, në Rambouillet të Francës, u organizuan bisedimet shqiptaro-serbe për t'i dhënë fund luftës. Pala shqiptare nënshkroi marrëveshjen e propozuar nga ndërmjetësuesit ndërkombëtarë, kurse serbët refuzuan të nënshkruanin. Në vështirim afatshkurtër, serbët fituan mundësi të shkallëzonin gjenocidin mbi shqiptarët dhe të zbatonin planet e tyre për spastrim etnik. Shqiptarët, ndërkaq, mbetën të ndarë në dy qeveri dhe dy krahë politikë: atë të luftës dhe UÇK-së dhe atë të rezistencës paqësore të Dr. Rugovës. Zhvendosja e popullsisë e shkaktuar nga luftimet shënoi kulmin gjatë muajit mars, kur forcat serbe filluan dëbimin me dhunë të shqiptarëve. Gati 1 milion banorë apo gjysma e popullsisë së Kosovës u çatdhësuan. 650.000, gjetën strehë në Shqipëri, me qindra mijëra u hodhën në vagonë mallrash ose u larguan me automjete private gjatë udhëtimit një javor në drejtim të Maqedonisë. Të përballur me dështimin e negociatave për paqe dhe bllokimin e veprimeve multilaterale përmes Këshillit të Sigurimit të OKB-së, Shtetet e Bashkuara ndërmorën fushatën për bombardimin e Jugosllavisë në bashkëpunim me Aleancën Veriatlantike, NATO-n. Të shtyrë nga qëllime humanitare, aleatët e NATO-s filluan më 24 Mars 1999, sulmet ajrore ndaj qarqeve ushtarake jugosllave për 78 ditë me radhë. Gjatë kësaj kohe, UÇK-ja vazhdoi konfrontimet ushtarake me trupat serbe, theu kufirin Shqipëri-Kosovë dhe mori nën kontroll pika strategjike. Më 10 Qershor të të njëjtit vit u arrit Marrëveshja e Kumanovës për tërheqjen e forcave serbe dhe hyrjen e forcave të NATO-s në Kosovë⁽²⁾.

Administrimi ndërkombëtar, statusi me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit

Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit u miratua më 10 Qershor 1999, pas marrëveshjes për tërheqjen e trupave serbe nga Kosova. Kjo rezolutë e përcakton statusin politik të Kosovës si protektorat të OKB-së dhe i jep administrimin e Kosovës po kësaj organizate ndërkombëtare. Sipas kësaj rezolute, OKB-ja ka përgjegjësinë për administratën civile, kurse NATO ka përgjegjësinë për sigurinë në Kosovë. Edhe pse rezoluta e bën Kosovën protektorat të OKB-së, në këtë rezolutë disa herë përmendet se Kosova është pjesë e Jugosllavisë. Në Rambouillet ishte hedhur ideja që një qeverisje e përkohshme do të zgjaste tre vjet. Politika publike me të gjitha aspektet e saj do të drejtohej nga administratorët e OKB-së. Kjo rezolutë u miratua në qershor të vitit 1999, me 14 vota pro dhe asnjë kundër dhe vetëm Kina abstenoj. Më tej rezoluta përmban respektimin e sovranitetit dhe integritetit territorial të RFJ dhe shteteve të tjera në rajon dhe se zgjidhja politike e Kosovës do të bazohej në parimet e përgjithshme në dy anekset e kësaj Rezolute. Atëherë, duke u bazuar në këtë rezolutë, Këshilli i Sigurimit autorizoi zbarkimin e prezencës ndërkombëtare civile dhe ushtarake nën patronazhin e OKB-ës. Pra në kuptimin e plotë të fjalës prezenca ndërkombëtare

do të kontrollohej nga një përfaqësues i posaçëm i Sekretarit të përgjithshëm të OKB-së, kurse prezenca ushtarake do t'i koordinonte punët me prezencën civile, por jo nën kontrollin e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së⁽³⁾.

Prezenca ushtarake kishte të drejtë:

- Të vinte në funksion armëpushimin;
- Të parandalonte armiqësitë;
- Të siguronte tërheqjen dhe të parandalonte kthimin e forcave të caktuara;
- Të siguronte rendin dhe qetësinë në periudhën e përkohshme;
- Të bënte monitorimin e kufijve;
- Të siguronte lirinë e lëvizjes;
- Të çmilitarizonte UÇK-në;
- Sipas nevojës, të përkrahte prezencën civile;

Prezenca civile kishte mandatin:

- Të promovonte dhe të themelonte një autonomi substanciale dhe vetëqeverisjeje në Kosovë në bazë të Marrëveshjes së Rambouillet-së;
- Të ushtronte funksione civile kurdo dhe për aq kohë sa kjo të ishte e nevojshme;
- Deri në zgjidhjen përfundimtare të politikave, përfshirë edhe zgjedhjet, të organizojë dhe të mbikqyrë zhvillimin e institucioneve të përkohshme për vetëqeverisjen demokratike dhe autonome etj.⁽⁴⁾

Rezoluta 1244 e KS të OKB-së, pas etnocidit të viteve 1998-1999 dhe ndërhyrjes së NATO-s për shpëtimin e popullit shqiptar nga spastrimi etnik, ka krijuar mbi Kosovën, si njësi e veçantë federative e ish RSFJ, kushtet për zhvillimin e një qeverisjeje të strukturuar sovrane. Kosova nga 15 Maji 2001, ka një “Constitutional Framework for Provisional Self-Government.” Kjo “Kornizë Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme” e përcakton Kosovën një entitet të veçantë, një protektorat nën administrimin e përkohshëm ndërkombëtar dhe një territor të pandashëm. Kosova ka një sistem ligjor të veçantë, ka një sistem qeverisjeje qendrore dhe lokale të zgjedhur në mënyrë demokratike, ka një sistem të drejtësisë të veçantë dhe kapacitetin de facto për të pritur misionet diplomatike të shteteve të tjera. Sovraniteti i këtyre institucioneve është i kufizuar vetëm nga pozicioni i kreut të Misionit të UNMIK dhe funksioni mbrojtës i KFOR. Pavarësisht faktit që kjo Rezolutë respekton sovranitetin dhe integritetin territorial të RFJ, përfshirë këtu edhe Kosovën, natyra e këtij sovraniteti ka qenë pastërtisht nominale, përderisa kjo Rezolutë, nëpërmjet konsiderimit “popull” të banorëve të kësaj krahine, ka njohur edhe të drejtën për vetëvendosje të këtij entiteti. Kosova është tanimë de facto protektorat i OKB-së⁽⁵⁾.

OKB, NATO dhe UMNİK në Kosovë

Që nga mbarimi i luftës është kërkuar nga shumica e popullit të Kosovës, shqiptarët, që statusi i Kosovës të mbarohet sa më parë që është e mundur. Por ndërkombëtarët gjithë kohën pohonin se ende është herët, dhe se Kosova ende ka probleme mes tjerash me respektimin e të drejtave të njeriut dhe

të pakicave. Në dhjetor 2003 bashkësia ndërkombëtare (BE, OKB) përmes “Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara” Harri Holkeri, u dorëzoi autoriteteve kosovare dokumentin “Standardet për Kosovën”. Dokumenti përmbante detyrat kryesore që Kosova duhej t’i realizonte deri në vitin 2005, në mënyrë që pastaj të vlerësoheshin arritjet dhe, nëse gjykohej se «standardet janë përmbushur», do të fillohej faza e ardhshme e përcaktimit të statusit final të Kosovës. Në preambulën e këtij dokumenti shkruante: “Një Kosovë ku të gjithë, pa marrë parasysh përkatësinë etnike, racën ose fenë, janë të lirë të jetojnë, punojnë dhe udhëtojnë pa frikë, armiqësi ose rreziqe dhe ku ka tolerancë, drejtësi dhe paqe për të gjithë”. Tani të gjitha kërkesat për zgjidhjen e statusit nga ndërkombëtares përgjigjeshin me “standardet para statusit”. Vetë OKB-ja nuk e pranoi Shtetin Sovran të Kosovës.⁽⁶⁾ NATO (Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior) është blloku perëndimor ushtarak.

Kjo organizatë u themelua me firmosjen e Traktatit Atlantiko-Verior më 4 Prill 1949, me qendër në Bruksel. Organizata ka themeluar një sistem mbrojtjeje kolektive, ku vendet anëtare bien dakord të mbrojnë njëra-tjetrën në rast sulmi nga një palë e jashtme. Misioni ushtarak i NATO-s në Kosovë është të sulmohen forcat ushtarake jugosllave dhe ato të sigurisë, si dhe objektet e lidhura me të, për të degraduar kapacitetet e tyre për vazhdimin e represionit kundër popullatës civile. NATO u vu në mbrojtje të parimeve të të drejtave të njeriut, të cilat kanë përparësi edhe në raport me sovranitetin e shteteve. Pikërisht kjo e bënte të ligjshëm sulmin e saj ndaj Federatës Jugosllave, qoftë edhe pa mandatin e OKB-së⁽⁷⁾. Projekti ndërkombëtar i ndërtimit të shtetit në Kosovë ka të ngjarë të jetë më gjithëpërfshirësi që ka qenë ndonjëherë, për sa i përket investimit ndërkombëtar. Misioni i Administratës së përkohshme të OKB-së në Kosovë (UNMIK) mori përsipër përgjegjësi të vetme për të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë që zakonisht i ka një qeveri kombëtare e një territori të caktuar. Sipas rregullores së vet të parë, të shpallur më 25 Korrik 1999, gjithë autoriteti legjislativ dhe ekzekutiv për sa i përket Kosovës, duke përfshirë këtu edhe administrimin e gjyqësorit, i jepet UNMIK-ut dhe ushtrohet nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm. UNMIK do të funksiononte me katër “Shtylla”. Shtylla I, e cila menaxhohej nga Zyra e OKB-së, ishte përgjegjëse për ndihmën humanitare. Shtyllës së II, gjithashtu nën mbikëqyrjen e OKB-ës, iu caktua detyra e administrimit civil. Shtylla III u drejtua nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (OSBE) dhe punoi për demokratizimin dhe ndërtimin e institucioneve. Shtylla IV u menaxhua nga Bashkimi Europian (BE) dhe iu dha detyra e rindërtimit dhe zhvillimit ekonomik.

Shpallja e pavarësisë dhe njohjet e para

Në Nëntor 2005 filloi zyrtarisht procesi për vendosjen e statusit përfundimtar të Kosovës. Që nga viti 1999, pasi forcat serbe u detyruan ta lëshonin Kosovën, ajo ka qenë e administruar nga misioni i Organizatës së Kombeve të Bashkuara UNMIK dhe institucionet demokratike të Kosovës: Kuvendi, Presidenti dhe Qeveria e Kosovës. Edhe pse Serbia nuk kishte kontroll mbi Kosovën, sipas rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit, përmendej se Kosova ishte protektorat i OKB-së, por juridikisht pjesë e Republikës Federale të Jugosllavisë. Sipas kësaj rezolute, OKB kishte përgjegjësinë për administratën civile kurse NATO, për sigurinë në Kosovë. Më 2 shkurt 2007, i dërguari special për statusin e Kosovës, Martti Ahtisaari, dorëzoi propozimin e tij në Prishtinë dhe në Beograd. Ky propozim përmbante disa elemente kryesore, të cilët kulmuan edhe me shpalljen e pavarësisë më 17 Shkurt 2008 si shtet i pavarur dhe sovran. Pavarësi e cila, siç e përmendëm edhe u më lart, u njoh për herë të parë nga Republika Islamike e Afganistanit dhe pasoi me Amerikën, Anglinë, Francën Turqinë, Shqipërinë etj.

Cilat shtete e njohën dhe përse?

Ashtu siç e përmendëm edhe më lart, njohja e pavarësisë së Kosovës është një proces në zhvillim. Ajo udhëhiqet nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Mbretëria e Bashkuar, të cilët, përveç stabilitetit dhe paqes në rajon, janë të interesuar që të ulin edhe ndikimin e Rusisë, e cila ashtu siç dihet, ka një përqsasje shumë të madhe me historinë dhe zhvillimin e shtetit serb në Ballkan. Rajon ky që vuajti për gati 10 vjet politikat shoviniste të këtyre dy shteteve motra. Një ndihmë shumë të madhe në këtë proces ka dhënë dhe po jep edhe Republika e Shqipërisë, e cila përveç interesit kombëtar ndër shekuj, ka të lidhur me Republikën e Kosovës edhe historinë e përbashkët të një kombi. Më poshtë vijon lista e disa prej shteteve që kanë pranuar pavarësinë e Kosovës.

Shteti	Dita e pranimit
1. Afganistani	17 Shkurt 2008
2. Kosta Rika	18 Shkurt 2008
3. Shqipëria	18 Shkurt 2008
4. Senegali	19 Shkurt 2008
5. Gjermania	20 Shkurt 2008
6. Letonia	20 Shkurt 2008
7. Danimarka	21 Shkurt 2008
8. Polonia	26 Shkurt 2008
9. Zvicra	27 Shkurt 2008
10. Austria	28 Shkurt 2008

BE dhe njohja e Kosovës

Bashkimi European ka qenë pjesë integrale e përpjekjeve ndërkombëtare për ndërtimin e një të ardhmeje të re për Kosovën që nga viti 1999. Bashkimi European – shtetet anëtare dhe institucionet e tij, veçanërisht Komisioni European – luan një rol të rëndësishëm në rindërtimin dhe zhvillimin e Kosovës. Bashkimi European është donatori më i madh që ofron ndihmë për Kosovën dhe rajonin e Evropës Juglindore në tërësi dhe udhëheq përpjekjet e rindërtimit. Kosova e deklaroi pavarësinë më 17 Shkurt 2008. Shumica e vendeve të Bashkimit Evropian gjithashtu e kanë njohur Kosovën (23 nga 28 shtete) Shtetet anëtare të Këshillit të Sigurimit janë të ndara sa i përket pavarësisë së Kosovës. SHBA, Britania e Madhe dhe Franca, njohën pavarësinë e Kosovës, Rusia e ka kundërshtuar dhe e ka konsideruar ilegal aktin e pavarësisë⁽⁸⁾, ndërsa Republika Popullore e Kinës shprehu mosmiratimin e saj për këtë akt. Me 15 Maj 2008, Rusia, Kina dhe India, lëshuan një deklaratë të përbashkët, në të cilën ftuan për negociata të reja në mes të autoriteteve të Beogradit dhe Prishtinës⁽⁹⁾.

Anëtarët e BE vendosin individualisht nëse do ta njohin Kosovën, ndërsa BE ka dërguar misionin EULEX për të siguruar paqe dhe mbikëqyrje të jashtme. Në Strasburg me 7 shkurt 2013 - Parlamenti European ka miratuar një rezolutë për Kosovën, duke i hapur kështu rrugën marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit mes BE dhe Kosovës. Në dokumentin për Kosovën të paraqitur nga eurodeputetja Urlike Lunaçek para komitetit për Politikë të Jashtme të PE-së, thuhet

se Bashkimi Evropian mund të lidhë Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit me Kosovën, edhe pse pesë vende të BE-së nuk e kanë njohur pavarësinë e saj. Eurodeputetja deklaroi se nuk mund të pranohet ndarja e Kosovës. Projekt-rezoluta gjithashtu u bën thirrje edhe pesë anëtarëve të tjerë të Bashkimit Evropian ta pranojnë shtetin e ri.⁽¹⁰⁾ BE e ka përsëritur (së fundmi në Këshillin Evropian në Dhjetor 2010) që Kosova ka një perspektivë të qartë europiane së bashku me të gjitha shtetet e Ballkanit. BE-ja mbetet e vendosur të luajë rolin udhëheqës në sigurimin e stabilitetit të Kosovës përmes misionit për sundimin e ligjit në kuadër të Politikës së Sigurimit dhe Mbrojtjes Europiane (ESDP), përmes Përfaqësuesit Special dhe gjithashtu kontributit për Zyrën Civile Ndërkombëtare (ICO). Kosova tashmë është konsoliduar dhe afirmuar si një shtet i pavarur dhe subjekt i pavarur i së drejtës ndërkombëtare dhe njohja e nga më tepër se gjysma e shteteve anëtare të OKB, e sanksion subjektivitetin e saj të pakthyeshëm ndërkombëtar.

Kosova në Gjykatën e Lartë të Drejtësisë në Hagë

Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë me qendër në Hagë, që përfaqëson gjykatën e nivelit më të lartë të Kombeve të Bashkuara, më datë 22 Korrik 2010, shpalli opinionin këshillëdhënës lidhur me ligjshmërinë e shpalljes së pavarësisë së Kosovës në vitin 2008. Sipas këtij opinionit, shpallja e pavarësisë së Kosovës më 17 Shkurt të 2008 nuk e ka shkelur të drejtën ndërkombëtare. Vendimi u mor me 10 vota pro dhe 4 kundër. Sipas gjykatës, nga të gjitha të dhënat pavarësia e Kosovës nuk ka shkelur as rezolutën 1244, si dhe kornizën kushtetuese të UNMIK. Vendimin mbi Kosovën në GJND në Hagë e kanë marrë 15 gjyqtarë, nga të cilët 9 vijnë nga vendet që kanë njohur pavarësinë e Kosovës, duke përfshirë edhe vetë kryesuesin, japonezin Hisashi Owada. Mendimi ose opinionit këshillëdhënës nuk është detyrues për shtetet. Çështja e legalitetit të aktit të njëanshëm të institucioneve të qeverisjes në Kosovës para GJND-së është shtruar nga Asambleja e Përgjithshme e KB në tetor të vitit 2008, me iniciativën e Serbisë. Gjatë shqyrtimit gojor që në gjykatën e Hagës ka zgjatur nga 1 Dhjetori deri më 11 Dhjetor të vitit 2009, 14 shtete, krahas autoriteteve të Prishtinës kanë vlerësuar se deklarata e miratuar më 17 Shkurt 2008 ka qenë legale, ndërsa 12 vende të tjera, bashkë me Serbinë, pohuan se me deklaratën u shkel e drejta ndërkombëtare.

Konkluzione

Si përfundim, mund të thuhet se ngjarjet e vitit 1968 ishin tepër të rëndësishme për të ardhmen e Kosovës dhe mund të themi që këto ngjarje ndajnë dy epoka, atë të tiranisë me atë të progresit. Këto ngjarje ishin katalizatori më i fuqishëm në përshpejtimin e avancimit të statusit politik të popullit shqiptar në trojet e veta etnike në ish-Jugosllavi. Demonstratat e shumta të ngritura nga populli i Kosovës ndërkombëtarizuan çështjen e Kosovës në botën e lirë, proces për të cilin politika jugosllave ishte përpjekur me dekada për ta ndaluar. Të gjitha këto ngjarje që ndodhën në trevat shqiptare në ish-Jugosllavi thyen mitin e Jugosllavisë si parajsë e popujve të lirë e të lumtur, të cilin e proklamonte politika jugosllave në çdo institucion ndërkombëtar. U arrit kështu faktorizimi i shqiptarëve dhe ngritja e vetëdijes kombëtare. Në këto drejtime ndodhën ndryshime të mëdha në proceset e ardhshme. Klasa e vjetër politike e Kosovës mbeti dogmatike dhe në kornizat e politikës së sistemit jugosllav, e destinuar të rrënohej kurdo që të shembej Jugosllavia. Ajo tani përballej me një lëvizje të re, e cila do ta sfidonte në vazhdimësi deri në triumfin përfundimtar të kësaj të fundit. Lëvizja e re politike shqiptare me frymë nacional-demokratike do ta vazhdojë luftën e saj duke marrë përkrahjen e shqiptarëve dhe botës së qytetëruar dhe në fund, edhe të vetë përfaqësuesve

të klasës së vjetër drejt krijimit të shtetit të Kosovës e deri në marrjen e statusit përfundimtar dhe shpalljen zyrtarisht me 17 Shkurt 2008, të Republikës së Kosovës. Ajo është tashmë një shtet i pavarur në Evropën Juglindore. Ajo që u synua të sillet nëpërmjet punimit të kësaj teme është dhe ndërgjegjësimi i të rinjve në lidhje me çështjet e Kosovës dhe të gjitha fazat që kaloi gjatë shumë viteve për të arritur përfundimin e synuar, statusin si një shtet i lirë dhe i bazuar në parimet e shtetit të së drejtës.

Referenca

1. Gurakuqi Romeo; Rruga e Mundimshme drejt Njohjes së Pavarësisë së Kosovës; Shkodër 2007; 7 fq.
2. Harillaq Kekezi, Rexhep Hida; Ç'thonë dhe Ç'kërkojnë Kosovaret-Përmbledhje studimesh, artikujsh, intervistash dhe komentesh; 8 Nëntori; 403 fq.
3. Ker-Lindsay James; KOSOVO- The path to contested statehood in the Balkans: I.B.Tauris; I.B. Tarius & Co Ltd; 1 Maj 2009; 288 fq.
4. Weller Marc; Shtetësia e kontestuar: Administrimi ndërkombëtar i luftës së Kosovës për pavarësi; Oxford University Press; Oxford 2009; 559 fq.
5. Gurakuqi Romeo; Rruga e Mundimshme drejt Njohjes së Pavarësisë së Kosovës; Shkodër 2007; 7 fq.
6. Kelmendi Muhamed; Realiteti dhe perspektivat e çështjes kombëtare; Zëri i Kosovës; albin Tiranë 1998; 199 fq.x
7. <http://prishtinapress.info/intervenimi-i-nato-s-në-kosovë/>
8. <http://www.guardian.co.uk/world/2008/feb/15/russia.kosovo;>
9. http://news.xinhuanet.com/english/2008-05/15/content_8179173.htm;
10. http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/eu_kosovo/political_relations/index_sq.htm;



**SHKENCAT
E APLIKUARA
DHE
EKONOMIKE**

SEKSIONI 3

